

## Partizani/ Firmos kamerunasi Jackson Eyinga Nna

nga AlbaniaSoccer  
E diel, 01 Shtator 2013 21:21

---



Mbrojtësi nga Kameruni Jackson Eyinga Nna është bërë pjesë e skuadës së Partizanit. Ai ka firmosur të shtunën pasdite duke u bërë zyrtarisht pjesë e formacionit të trajnerit Lika. Lojtari kohët e fundit është aktivizuar me skuadrën e Union Douala në Kamerun. Pas paraqitjes premtuese në ndeshjen e parë të këtij sezoni, ndaj Kastriotit ku dhe fituan 2 me 0, të kuqtë duken se po i rikthehen vullshëm kampionatit. Javën e kaluar kanë firmosur dhe Sodje Onome, nga Nigeria i cili është bashkuar ekipit. Me ardhjen e lojtareve Onome dhe Nna merkato konsiderohet e mbyllur për Partizanin.